

Vendim nr. 182, datë 04.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 04.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (Gj) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GJERGJ GJOKAJ**, përfaqësuar nga avokati Lazër Sallaku, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4013, datë 04.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 27, 28 dhe 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi personalisht dhe si përfaqësues i trashëgimtarëve të tjerë ligjorë të ish-pronarëve P.T.K. dhe M.T.K. i është drejtuar ish-Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave pranë Bashkisë së Lezhës (KKKP-ja, *Lezhë*) për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të këtyre ish-pronarëve. KKKP-ja, Lezhë, me vendimin nr. 15, datë 21.07.1994, ka vendosur t'u njohë atyre pronësinë mbi një truall dhe t'i kompensojë në obligacione për një tjetër sipërfaqe, ndërsa me vendimin nr. 15/1, datë 09.01.1998, KKKP-ja, Lezhë ka vendosur mos t'u njohë trashëgimtarëve pronësinë mbi një sipërfaqe toke prej 141.523 m². Ky vendim i fundit pretendohet nga kërkuesi se është anuluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila, me vendimin nr. 76, datë 30.03.1998 (*vendimi nr. 76/1998*), ka vendosur t'u njohë trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarëve pronësinë për një sipërfaqe toke prej 129,713 m², kompensimin në obligacione shtetërore për sipërfaqen prej 116,723 m², kthimin në pronësi të sipërfaqes së truallit prej 12,990 m² dhe rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.

2. Me pretendimin se brenda sipërfaqes prej 116,723 m² (njohur me të drejtë kompensimi) ka sipërfaqe të lira, të cilat, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës, të ndryshuar (*ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës*) mund t'u kthehen në natyrë këtyre subjekteve, trashëgimtarët ligjorë të ish-pronarëve, në datën 28.05.2007, i janë drejtuar me kërkesë Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Lezhë (ZRAKKP-ja, *Lezhë*). Me vendimin nr. 69, datë 29.02.2008 të ZRAKKP-së, Lezhë (*vendimi nr. 69/2008*) është vendosur kthimi i sipërfaqes prej 20,974 m² dhe kompensimi për sipërfaqen prej 95,749 m² (që përbëjnë pjesën prej 116,723 m² të njohur për kompensim), si dhe mosnjohja e së drejtës së pronësisë për sipërfaqen prej 20,287 m².

3. Vendimi i mësipërm i është nënshtruar kontrollit të ligjshmërisë me iniciativën e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), Tiranë, i cili, në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. 619, datë 06.06.2008 (*vendimi nr. 619/2008*), ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 69/2008 të ZRAKKP-së, Lezhë dhe kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme me detyra të përcaktuara. Gjithashtu, kundër vendimit të ZRAKKP-së, Lezhë ka ushtruar të drejtën e ankimit edhe kërkuesi. Lidhur me këtë kërkesë ankimore, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, Tiranë me vendimin nr. 639, datë 23.08.2008 (*vendimi nr. 639/2008*), ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 69/2008 të ZRAKKP-së, Lezhë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj zyre me detyra të përcaktuara. Në vijim, ZRAKKP-ja, Lezhë ka marrë sërish në shqyrtim çështjen dhe me vendimin nr. 191, datë 22.09.2008 (*vendimi nr. 191/2008*), ka vendosur moskthimin e pronës së pretenduar prej 150 dynmësh tokë truall në qytetin e Lezhës,

trashëgimtarëve ligjore të ish-pronarëve. Ky vendim është kundërshtuar në Zyrën Qendrore të AKKP-së, Tiranë me kërkesën ankimore të datës 21.11.2008.

4. Ndërkohë që kërkesa ankimore ishte duke u shqyrtuar në AKKP-në, Tiranë, në datën 26.05.2010 Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 (*vendimi nr. 27/2010*), ka vendosur shfuqizimin e shkronjave “c”, “ç”, “d” e “dh” të pikës 1 të nenit 15 dhe nenit 16 të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, të ndryshuar me ligjin nr. 10207/2009. Gjykata ka arsyetuar se pushteti i AKKP-së, Tiranë për të shqyrtuar vendimet e ish-komisioneve të pronave, edhe me nismën e saj, ishte antikushtetues. Sipas Gjykatës, një kërkesë e paraqitur pranë ish-komisioneve të pronës ishte ekuivalente me një padi të paraqitur në gjykatë dhe, për këtë arsye, vendimet e ish-komisioneve të pronave krijonin të njëjtat pritshmëri ashtu si vendimet gjyqësore, pasi ato nuk ishin vetëm akte administrative, por vendime me natyrë *quasi* gjyqësore. Nisur nga kjo, sipas saj, vetëm një autoritet gjyqësor dhe jo një autoritet administrativ, si AKKP-ja, mund të shqyrtonte një masë për rishikimin e një vendimi të ish-komisioneve të pronave. Gjykata ka theksuar se, në mungesë të një ankese, vendimet e ish-komisioneve të pronave bëheshin të formës së prerë, detyruese për palët në procedime dhe të zbatueshme sipas ligjit, njësoj si vendimet gjyqësore. Në datën 22.07.2010 është miratuar ligji nr. 10308, datë 22.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës, të ndryshuar”” (*ligji nr. 10308/2010*), i cili ndryshonte sërish ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës, duke i rikthyer të njëjtat kompetenca drejtorit të AKKP-së, Tiranë. Gjykata, me vendimin nr. 43, datë 06.10.2011 (*vendimi nr. 43/2011*), ka vendosur shfuqizimin e neneve 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 10308/2010, duke arsyetuar, me të njëjtat argumente, se ato cenonin parimin e sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës.

5. AKKP-ja Tiranë, me vendimin nr. 295, datë 29.01.2013, ka vendosur mungesën e juridiksionit dhe të kompetencës për shqyrtimin e kërkesës ankimore të kërkuarit, të vitit 2008, për shkak të vendimeve nr. 27/2010 dhe nr. 43/2011 të kësaj Gjykate, të cilat shfuqizuan dispozitat ligjore që legjitimonin AKKP-në, Tiranë që të vazhdonte trajtimin dhe shqyrtimin e ankimeve të depozituara nga subjektet.

6. Në këto kushte, në datën 28.02.2013, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimeve nr. 619/2008 dhe nr. 639/2008 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë, të vendimit nr. 191/2008 të ZRAKKP-së, Lezhë, si dhe ndryshimin e pikave 1, 2 dhe 3 të vendimit nr. 69/2008 të ZRAKKP-së Lezhë, duke pretenduar kthimin fizik të të gjitha sipërfaqeve të tjera të lira, brenda sipërfaqes

së njohur me vendimin nr. 76/1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarëve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9293, datë 29.09.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi ka arritur në përfundimin se vendimet e kundërshtuara nuk janë absolutisht të pavlefshme. Për vendimin nr. 619/2008 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë (pas kontrollit me iniciativë të tij) që shfuqizoi vendimin fillestar të ZRAKKP-së, Lezhë (vendimin nr. 69/2008), ajo gjykatë arsyetoi se paditësi nuk provoi se vendimi ishte marrë jashtë afatit ligjor, pasi nuk u dëshmuua data e njoftimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë për vendimin e dhënë nga zyra rajonale. Më tej, ajo gjykatë ka evidentuar se vetë vendimi fillestar nr. 69/2008 i ZRAKKP-së, Lezhë është dhënë përtej afateve ligjore. Në këtë kuptim, sipas saj, nëse shkelja e afatit do të përbënte shkak pavlefshmërie absolute, atëherë edhe vendimi që paditësi pretendon të mbetet në fuqi do të ishte i pavlefshëm.

7. Edhe vendimi nr. 639/2008 i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë (pas kërkesës ankimore të kërkuarit), pra vendimi i dytë që ka shfuqizuar vendimin fillestar nr. 69/2008 të ZRAKKP-së Lezhë gjithashtu nuk është i pavlefshëm sipas gjykatës. Ajo gjykatë ka arsyetuar se organi administrativ është shprehur dy herë, por është shprehur për shkaqe të ndryshme dhe në përputhje me ligjin, si dhe me një qëndrim koherent, duke arritur në të njëjtin përfundim në të dyja rastet.

8. Për gjykatën e shkallës së parë, edhe vendimi përfundimtar i zyrës rajonale, vendimi nr. 191/2008 i ZRAKKP-së, Lezhë, me të cilin është rrëzuar kërkesa e kërkuarit, është një vendim i dhënë në zbatim të vendimeve të mëparshme dhe në përputhje me ligjin dhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes. Gjykata ka evidentuar se paditësi (kërkuari) nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar, veçanërisht vendimin gjyqësor nr. 76/1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe hartën që e shoqëronte atë, të cilat përbënin themelin e kërkesës për kthimin fizik të pronës, si dhe nuk ka dhënë asnjë argument konkret për mosparaqitjen e këtij vendimi, as përpara organit administrativ, as në gjykim përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9. Ndërsa për vendimin fillestar nr. 69/2008 të ZRAKKP-së, Lezhë ajo gjykatë ka arsyetuar se nuk është më në fuqi dhe nuk mund të ndryshohet sipas kërkesës së paditësit. Edhe në hipotezën që kërkesat do të pranoheshin në parim, kërkuari nuk ka arritur të provojë pretendimet e tij as gjatë procesit administrativ, as në gjykim, duke mos paraqitur dokumentacionin thelbësor që shoqëronte vendimin gjyqësor të formës së prerë për njohjen e pronës. Kjo mungesë dokumentacioni ishte

arsyeja kryesore e kthimit për rishqyrtim, e rrëzimit të kërkesës dhe e pamundësisë për përpilimin e aktit të ekspertimit nga ana e ekspertit.

10. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2580, datë 22.12.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me po të njëjtën linjë arsyetimi si ajo. Pretendimin se vendimi ka fuqi prapavepruese ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, sipas nenit 76 të Ligjit Organik të Gjykatës, gjykata e apelit e ka vlerësuar te pabazuar me arsyetimin se në kohën e dhënies së vendimit kushtetues, çështja e kërkuarit nuk ka qenë duke u shqyrtuar në gjykatë (*shih faqen 6 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuar.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4013, datë 04.11.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Shkaqet e parashtruara në rekurs, sipas Gjykatës së Lartë, ngrenë kryesisht çështje të vlerësimit të provave dhe të fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të saj. Ajo gjykatë ka konstatuar se nga ana e gjykatave më të ulëta janë respektuar normat procedurale, të cilat mund të çonin në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit dhe nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat mund të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve. Po kështu, ajo ka konstatuar se janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material dhe se gjykatat kanë bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

12. Gjykata e Lartë ka çmuar se gjykatat kanë zbatuar në mënyrën e duhur vendimin nr. 27/2010 të kësaj Gjykate, pasi ky vendim është i zbatueshëm pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe nuk mund të zbatohet me efekte prapavepruese për të kundërshtuar për pavlefshmëri vendimet objekt gjykimi. Drejtori i AKKP-së, Tiranë ka marrë në shqyrtim vendimin e zyrës rajonale në kohën kur ligji ia njihte këtë të drejtë dhe kërkuar nuk e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin e drejtorit për prishjen e vendimit të ZRAKKP-së, Lezhë për kthimin e çështjes për rishqyrtim. Për rrjedhojë, me të drejtë, gjykatat e faktit kanë konkluduar se vendimi nr. 69/2008 i ZRAKKP-së, Lezhë kishte rënë nga fuqia. Gjithashtu, gjykatat e faktit kanë shqyrtuar edhe në themel pretendimet dhe provat e paraqitura nga kërkuar kundër vendimit të fundit të ZRAKKP-së Lezhë (nr. 191/2008) për moskthimin e pronës, duke e gjetur të drejtë këtë vendim lidhur me rrëzimin e kërkesës për kthimin në natyrë të sipërfaqes së pretenduar. Në rastin objekt shqyrtimi,

sipas saj, palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë për to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Vendimet e gjykatave më të ulëta nuk bien në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

13. Në datën 03.03.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuetit

14. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

14.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse gjendej përpara pretendimeve me natyrë kushtetuese të lidhura me të drejtën substanciale të pronës, nuk u ka dhënë një përgjigje të argumentuara atyre.

14.2. *Parimi i sigurisë juridike* i lidhur me të drejtën e pronës, pasi vendimet e kundërshtuara bien ndesh me vendimin nr. 27/2010 të kësaj Gjykate, e cila ka konkluduar se vendimet e AKKP-ve për të shfuqizuar vendimet e formës së prerë të KKKP-së, Lezhë cenojnë parimin e sigurisë juridike. Vendimet e kundërshtuara kanë legjitimuar drejtorin e përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë për të shqyrtuar kryesisht një vendim të KKKP-ve në cenim të parimit të sigurisë juridike. Vendimi nr. 639/2008 i AKKP-së, Tiranë është absolutisht i pavlefshëm, pasi është nxjerrë për të njëjtin vendim (nr. 69/2008 i ZRAKKP-së, Lezhë), për të cilin është nxjerrë më parë vendimi nr. 619/2008 po i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë për të shfuqizuar vendimet e KKKP-ve.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose

juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

17. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit formalisht të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Lidhur me këtë kusht të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual, për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për bazueshmërinë në prova të kërkimeve të tij të pronësisë, bazuar në përmbajtjen e vendimit nr. 76/1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, gjykatat e zakonshme e kanë rrëzuar këtë pretendim, duke arsyetuar se kërkuesi nuk ka paraqitur as pranë organit administrativ dhe as në gjykatë kopjen e njësuar të këtij vendimi gjyqësor dhe planvendosjen përkatëse. Në lidhje me këtë pjesë të arsyeve për rrëzimin e padisë së kërkuesit, as në apel e as në rekurs kërkuesi nuk ka paraqitur argumente për të nxjerrë në pah se gjykatat kanë gabuar në vlerësimin e tyre. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë shkak ankimi në lidhje me këtë aspekt thelbësor për të cilin i është rrëzuar padia, ndaj, për këtë pjesë, Gjykata vlerëson se ai nuk ka shteruar në substancë mjetet juridike efektive në dispozicion.

18. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 04.11.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 03.03.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës.

20. Për të mbështetur pretendimet për *procesin e rregullt ligjor*, kërkuesi ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimet e gjykatave të faktit nuk kanë respektuar vendimin nr. 27/2010 të kësaj Gjykate për konstatimin e saj se pushteti i AKKP-së, Tiranë për të shqyrtuar vendimet e ish-komisioneve të pronave ishte i papajtueshëm me Kushtetutën. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi me natyrë kushtetuese të kërkuetit. Edhe pretendimin për cenimin e *së drejtës së pronës* kërkuesi e ka lidhur me arsyetimet e vendimeve të gjykatave të zakonshme. Nisur nga thelbi dhe përmbajtja e pretendimeve të kërkuetit, si dhe në konsideratë të faktit se neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë, ku përfshihet edhe e drejta për pronë private, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Kolegji çmon që, në rastin konkret, pretendimet e kërkuetit të analizohen në themel në drejtim të *së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* që, *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

21. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara kanë legjitimuar drejtorin e përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë për të shqyrtuar kryesisht një vendim të komisionit për kthimin dhe kompensimin e pronës, në cenim të parimit të sigurisë juridike dhe në kundërshtim me vendimin nr. 27/2010 të kësaj Gjykate. Ky pretendim me natyrë kushtetuese, i ngritur në rekurs, nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë. Ndërsa vendimi nr. 639/2008 i AKKP-së, Tiranë është absolutisht i pavlefshëm, pasi është nxjerrë për të njëjtin vendim për të cilin është nxjerrë më parë vendimi nr. 619/2008 po i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë.

22. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues e ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ndërkohë, neni 142, pika 1, i Kushtetutës parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

23. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht

formal. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykim. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në jurisprudencë konstante të Gjykatës është pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, është shprehur se në vlerësimin e shkaqeve ligjore të rekursit dhe bazueshmërisë së tyre duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore, nëse kolegji i Gjykatës së Lartë krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, vendos mospranimin e tij (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata në vijimësi është shprehur se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese, Kolegji vëren se kërkesa ankimore e kërkuarit kundër vendimit nr. 191/2008 të ZRAKKP-së, Lezhë është e vitit 2008 dhe se vendimet

e kësaj Gjykate janë të viteve 2010 dhe 2011, ndërsa kërkuesi nuk rezulton t'i jetë drejtuar gjykatës në atë kohë. Vetëm në datën 28.02.2013, rreth 1 muaj pas vendimit të AKKP-së, Tiranë për mungesën e juridiksionit dhe të kompetencës për shqyrtimin e kërkesës ankimore të kërkuetit, ai i është drejtuar gjykatës me kërkesë për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të të dyja vendimeve të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë, të vitit 2008, të vendimit të ZRAKKP-së, Lezhë pas rishqyrtimit, nëpërmjet të cilit është vendosur moskthimi i pronës së pretenduar trashëgimtarëve të ish-pronarëve, si dhe ndryshimi i vendimit fillestar të ZRAKKP-së, Lezhë, duke pretenduar kthimin fizik të të gjitha sipërfaqeve të tjera të lira, brenda sipërfaqes së njohur me vendimin nr. 76/1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Një argument thelbësor i kërkuetit lidhet me faktin se kjo Gjykatë, me vendimet nr. 27/2010 dhe nr. 43/2011, i ka gjetur jokushtetuese kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë për të rishikuar vendimet e formës së prerë të komisioneve për kthimin dhe kompensimin e pronës.

27. Sikurse u parashtrua në rrethanat e çështjes, gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar padinë e kërkuetit, pasi vendimet e kundërshtuara nuk i ka gjetur absolutisht të pavlefshme. Lidhur me pretendimin për kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë ajo gjykatë ka evidentuar se padia e kërkuetit është ngritur në vitin 2013, ndërsa vendimet e kësaj Gjykate janë përkatësisht të viteve 2010 dhe 2011, pra çështja e kërkuetit nuk ka qenë duke u shqyrtuar në gjykatë në momentin e vendimeve kushtetuese, ndaj ato nuk kanë fuqi prapavepruese për çështjen e kërkuetit. Në këtë kuptim, ajo gjykatë ka arsyetuar se në kohën e marrjes së vendimeve drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, Tiranë ka vepruar brenda kompetencës së tij ligjore. Për pretendimin se drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, Tiranë ka shfuqizuar dy herë vendimin fillestar nr. 69/2008 të ZRAKKP-së, Lezhë, një herë me iniciativë të tij dhe një herë për shkak të kërkesës ankimore të kërkuetit, ajo gjykatë ka arsyetuar se me të vërtetë organi administrativ është shprehur dy herë, por është shprehur për shkaqe të ndryshme dhe në përputhje me ligjin dhe me një qëndrim koherent, duke arritur në të njëjtin përfundim në të dyja rastet (*shih paragrafët 6-10 të vendimit*). Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit me të njëjtën linjë arsyetimi, si në tërësi, ashtu edhe posaçërisht për fuqinë prapavepruese të vendimeve të Gjykatës (*shih paragrafin 11 të vendimit*).

28. Ndërsa Gjykata e Lartë, pavarësisht se ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuetit, ka shqyrtuar shkaqet kryesore të ngritura në të, duke u dhënë përgjigje atyre. Gjykata e Lartë ka çmuar se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar në mënyrën e duhur vendimin nr. 27/2010 të kësaj Gjykate, i cili ka qenë i zbatueshëm pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe nuk mund të zbatohet me

efekte prapavepruese për të kundërshtuar për pavlefshmëri vendimet objekt gjykimi (*shih paragrafët 12 dhe 13 të vendimit*). Duke pasur parasysh edhe natyrën e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit, në kuadër të verifikimit të kriterëve të pranueshmërisë së rekursit të kërkuarit, është vendosur mospranimi i tij, Kolegji vlerëson se, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuari, arsyetimi i këtij vendimi, sipas jurisprudencës kushtetuese, nuk rezulton në cenim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

29. Nën këtë optikë, Kolegji çmon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në vendimet e kundërshtuara përmes ankimit kushtetues individual, kanë përmbushur detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre, ndërkohë që interpretimi i ligjit nga ato, i shprehur përmes arsytimit, nuk rezulton i paarsyeshëm në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimin e kërkuarit në padi, ankim dhe rekurs për fuqinë prapavepruese të vendimeve të kësaj Gjykate, në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë. Ato gjykata kanë arritur në përfundimin se vendimet nr. 27/2010 dhe nr. 43/2011 të kësaj Gjykate nuk ishin të zbatueshme për rastin e kërkuarit, në kushtet që ai i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi vetëm në vitin 2013, ndërkohë që asnjë çështje e tij nuk ishte në pritje për t'u gjykuar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre vendimeve. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.